

Dr. Petrit Gashi

Profesor i asociuar
Fakulteti Ekonomik
Universiteti i Prishtinës
Kati 7, zyra 84
petrit.gashi@uni-pr.edu

EKONOMIKS I TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Lënda nisët nga premisa se sot gati që është e pamundur të studiohet një fenomen ekonomik pa e parë atë nga prizmi ndërkombëtar. Apo, është e pamundur gjithashtu të kuptohen zhvillimet në ekonominë vendore nëse nuk studiohen raportet e saj me ekonomitë e tjera. Në këtë kontekst, lënda e Ekonomiks të Tregtisë Ndërkombëtare trajton dy dimensione të veçanta: së pari, teoritë e tregtisë ndërkombëtare, dhe së dyti, instrumentet e politikës tregtare. Në mënyrë specifike, lënda mbulon:

- Hyrje në ekonomiks ndërkombëtar;
- Rrjedhat globale në tregtinë e jashtme;
- Teoria e Përparësive Krahasuese: Modeli i Rikardos I
- Teoria e Përparësive Krahasuese: Modeli i Rikardos II
- Teoria Standarde e Tregtisë Ndërkombëtare
- Parimet dhe konceptet e politikës tregtare
- Instrumentet e politikës tregtare: tarifat
- Instrumentet e politikës tregtare: kuotat në import
- Instrumentet e politikës tregtare: masat e tjera jo-tarifore
- Instrumentet e politikës tregtare: liberalizimi i tregtisë

Qëllimet dhe rezultatet e pritura:

Qëllimi primar i lëndës është t'u ndihmojë studentëve të krijojnë një qasje analitike të studimit të çështjeve bashkëkohëre të ekonomisë ndërkombëtare.

Me përfundimin e mësimit studenti duhet të njohë qartë konceptet bazë të modelit të Rikardos dhe modeleve të tjera teorike të lidhur me konceptin e përparësive krahasuese. Gjithashtu studentët duhet ti njohin mirë mekanizmat tariforë dhe jo-tariforë si dhe ndikimin e tyre në ekonomi. Si dhe të jenë në dijeni për elementet kyçe të politikës tregtare të Kosovës.

Format e mësimdhënies dhe mësim nxënies:

Që në fillim të mësimit studentëve iu komunikohet lënda, dhe të gjitha aspektet e tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e mesimit gjatë semestrit, përfshirë këtu edhe përgjegjësitë dhe obligimet edhe të mësimdhënësit dhe studentëve.

Studentët inkurajohen të janë pjesë aktive e mësimit përmes diskutimeve të ndryshme për secilin aspekt që ngritet brenda temave të caktuara dhe detyrave konkrete në mësim dhe në pjesën e ushtrimeve. Studentët inkurajohen të bëjnë punë të pavarur studimore.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi i studentëve bëhet gjatë mësimit përmes dy testeve, apo edhe përmes provimeve në afatet e rregullta. Në notën përfundimtare përfshinet i gjithë aktiviteti i studenteve në mësime, përfshirë prezencën në mësime, aktivizimin në diskutim, detyrat, punën e pavarur, aktivitetin gjatë ushtrimeve, etj.

Mjetet e konkretizimit / TI:

Mësimdhënia konkretizohet përmes ligjeratave, prezentimeve, punimeve seminarike dhe diskutimit të tyre, dhe përmes shembujve të ndryshëm konkret që vendosin një lidhje të qartë në mes të teorisë dhe praktikës.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Kujdes i veçantë i kushtohet raportit praktikë-teori. Pasi që lënda në thelb është teorike, përmes shembujve të ndryshëm konkret synohet të konkretizohen çështjet e diskutuara. Në raste të caktuara ftohen edhe mysafir nga bota akademike apo ajo e biznesit për të ndarë dijet e tyre me studentët.

Literatura:

- Mancellari, A. (2002), Tregtia Ndërkombëtare, Tiranë: SHBLU
- Salvatore, D. (2007), International Economics, botimi i nëntë, New York: Wiley
- Krugman, P.R. and Obstfeld, M. (2003), International Economics: Theory and Policy, edicioni i gjashtë, New York: Addison-Wesley.